REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI I SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Br. 284/20
Datë/Datum 15.06.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH .nr.284/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068 dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të: Nuhi Paçarizi - Kryetar, Blerim Dina - Referues dhe Goran Milenković – Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga OE "TFS Group" SHPK & "Laguna" SHPK & "King Security" – Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë: OE "KS A.S.S" lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: " Shërbime të mirëmbajtjes higjenike të objekteve, mirëmbajtje e hapësirave publike dhe sigurim fizik i objekteve" – Lot 2, me nr. të prokurimit: 634-20-328-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Klinë.", më datën 12.06.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. <u>REFUZOHET</u>, si e pa bazuar ankesa e operatorit ekonomik "TFS Group" SHPK & "Laguna" SHPK & "King Security" – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Shërbime të mirëmbajtjes higjenike të objekteve, mirëmbajtje e hapësirave publike dhe sigurim fizik i objekteve" – Lot 2, me nr. të prokurimit: 634-20-328-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Klinë.

II. <u>VËRTETOHET</u>, njoftimi për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Shërbime të mirëmbajtjes higjenike të objekteve, mirëmbajtje e hapësirave publike dhe sigurim fizik i objekteve" – Lot 2, me nr. të prokurimit: 634-20-328-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Klinë.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik OE "TFS Group" SHPK & "Laguna" SHPK & "King Security" – Prishtinë, refuzohet si e pa bazuar, i bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues OE "TFS Group" SHPK & "Laguna" SHPK & "King Security" – Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 15.01.2020 me nr. 284/20, kundër njoftimit mbi dhënien e kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: " Shërbime të mirëmbajtjes higjenike të objekteve ,mirëmbajtje e hapësirave publike dhe sigurim fizik i objekteve" – Lot 2, me nr. të prokurimit: 634-20-328-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Klinë duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7,56,59, 61 dhe 69 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 12.05.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 18.05.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Pretendimi nr.1; Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues eliminohet nga ky aktivitet i prokurimit (LOT 2) me arsyetimin se nuk e ka llogaritur TVSH-ne, në paramasën e tij të dorëzuar pranë AK-Komunës Kline. Eksperti shqyrtues pasi ka analizuar paramasën e OE ankues, për Lot 2, sqaron se në rubrikën e TVSH-se i njëjti nuk ka vendosur fare vlerën prej 18% te TVSH-se dhe çmimi i dhënë nga OE ankues në paramasë dhe formular të tenderit është 78,058.00 €. AK-ja, gjate vlerësimit e ka vërejtur se i njëjti nuk e ka vendosur vlerën e TVSH-se dhe të njëjtit i ka dërguar letrën standarde për korrigjim të çmimit. Pas pranimit të kërkesës se AK-se, OE ankues ka kthyer përgjigje, ku pretendon se çmimi i dhëne është në total duke përfshire edhe TVSH-ën. Eksperti shqyrtues, pasi ka analizuar paramasën dhe parallogarinë e OE ankues për Lot 2, sqaron se të pjesa e paramasës ku është kërkuar qe të vendoset vlera e TVSH-se, OE ankues nuk ka vendosur çmim, pra e len me 00, qe do të thotë se i njëjti nuk ka ofruar TVSH-në dhe ne rastin konkret nëse i shtojmë vlerën e prej 18% te TVSH-se, atëherë oferta e OE ankues rezulton të jetë mbi vlerën e parashikuar për Lot 2 qe është 80,000.00€.

Pretendimi i OE ankues se në totalin e dhënë është TVSH-ja, nuk qëndron për faktin se siç u sqarua edhe me larte i njëjti nuk ka dhëne vlere të TVSH-se ne rubrikën e paramasës dhe parallogarisë.

Eksperti shqyrtues, po ashtu vlerëson se AK-ja në kundërshtim me dispozitat e LPP-se, konkretisht nenit

59 të LPP-se, i ka dërguar kërkese për sqarim të vlerës se TVSH-së, për faktin se në rastet kur OE-te, nuk e përfshijnë vlerën e TVSH-se, AK-ja është e obliguar qe të përmirësoje gabimet dhe nuk është e nevojshme qe të dërgojë kërkese për korigjim të çmimit, megjithatë kjo nga ekspertet shqyrtues, konsiderohet shkelje procedurale qe nuk ka ndikuar në vlerësimin përfundimtarë. Ne fund, ekspertet shqyrtues, vlerësojnë se ankesa e OE ankues është e pa bazuar, për faktin se çmimi i dhënë në total nuk rezulton të jetë e përfshirë edhe TVSH-ja, prandaj AK-Komuna Kline me të drejte e ka eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzohet si e pa bazuar ndërsa vendimi i AK-se për Lot 2 te mbetet në fuqi.

Autoriteti Kontraktues, me datën 18.05.2020 me anë të parashtresës, e ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik, me datën 21.05.2020 me anë të parashtresës, e ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 12.06.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se OE ankues eliminohet nga ky aktivitet i prokurimit (LOT 2) me arsyetimin se nuk e ka llogaritur TVSH-në në paramasën e tij të dorëzuar pranë AK-Komunës Kline. OE ankues "TFS Group" SHPK & "Laguna" SHPK & "King Security" – Prishtinë në rubrikën e TVSH-së nuk ka vendosur fare vlerën prej 18% të TVSH-së dhe çmimi i dhënë nga OE ankues në paramasë dhe formular të tenderit është 78,058.00 €. Ndërsa AK-ja, gjate vlerësimit e ka vërejtur se i njëjti nuk e ka vendosur vlerën e TVSH-së dhe të njëjtit i ka dërguar letrën standarde për korrigjim të çmimit. Pas pranimit të kërkesës së AK-së, OE ankues ka kthyer përgjigje, ku pretendon se çmimi i dhënë është në total duke përfshirë edhe TVSH-ën.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se pasi ka analizuar paramasën dhe parallogarinë e OE ankues për Lot 2, vlerëson se të pjesa e paramasës ku është kërkuar që të vendoset vlera e TVSH-se,

OE ankues nuk ka vendosur çmim, pra e len me 00, që do të thotë se i njëjti nuk ka ofruar TVSH-në dhe në rastin konkret nëse i shtojmë vlerën e prej 18% të TVSH-së, atëherë oferta e OE ankues rezulton të jetë mbi vlerën e parashikuar për Lot 2 që është 80,000.00€.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "TFS Group" SHPK & "Laguna" SHPK & "King Security" – Prishtinë se në totalin e dhënë është TVSH-ja, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se nuk qëndron ky pretendim i OE ankues për faktin se siç u sqarua edhe me larte i njëjti nuk ka dhënë vlerë të TVSH-se në rubrikën e paramasës dhe parallogarisë.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues vlerëson se autoriteti kontraktues në kundërshtim me dispozitat e LPP-së, konkretisht nenit 59 të LPP-se, i ka dërguar kërkesë për sqarim të vlerës se TVSH-së, për faktin se në rastet kur OE-të nuk e përfshijnë vlerën e TVSH-së, AK-ja është e obliguar që të përmirësoj gabimet dhe nuk është e nevojshme që të dërgojë kërkesë për korrigjim të çmimit, megjithatë kjo nga ekspertet shqyrtues, konsiderohet shkelje procedurale që nuk ka ndikuar në vlerësimin përfundimtar.

Andaj, Paneli Shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës dhe sqarimet e eksperteve shqyrtuese, sqaron se AK gjatë ekzaminimit të tenderëve ka bërë vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë, njëherit duke pasur parasysh edhe nenin 59 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Nuhi Paçarizi

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK- Komuna Klinë

1x1 OE ankues - "TFS Group" SHPK & "Laguna" SHPK & "King Security"

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.